



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Seanca plenare e Kuvendit

P- 005

Prishtinë, më 18 dhjetor 2014

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 DHJETOR 2014**

Seancën e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e seancës plenare, të caktuar nga Kryesia e Kuvendit. Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 108 deputetë.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit dhe me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës është bërë zëvendësimi i deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim:

Nga Grupi Parlamentar PDK, PD, LB, PSHDK, PKK:

Nait Hasani e zëvendëson Hashim Thaçin; Shaip Muja e zëvendëson Hajredin Kuçin; Fadil Demaku e zëvendëson Arsim Bajramin; Hajdar Beqa e zëvendëson Memli Krasniqin dhe Salihe Mustafa e zëvendëson Edita Tahirin.

Nga Grupi Parlamentar LDK:

Murat Hoxha e zëvendëson Isa Mustafën; Agim Kikaj e zëvendëson Kujtim Shalën; Bardhyl Metaj e zëvendëson Haki Demollin; Milazim Haliti e zëvendëson Avdullah Hotin dhe Synavere Mustafa e zëvendëson Hykmete Bajramin.

Nga Grupi Parlamentar Partia Demokratike Turke e Kosovës (KDTP):

Fikrim Damka e zëvendëson Mahir Jagcilarin.

Nga Grupi Parlamentar Koalicioni VAKAT:

Cerim Bajrami e zëvendëson Rasim Demirin.

Nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”:

Faton Topalli e zëvendëson Dardan Sejdiun.

Kryetari u dëshiroi mirëseardhje dhe punë të mbarë në Kuvend deputetëve të rinj dhe ftoi ata që ta nënshkruajnë tekstin e betimit, gjë që ata e bënë.

Kryetari gjithashtu i njoftoi deputetët e Kuvendit se deputetja Emilija Rexhepi, nga data 18 dhjetor 2014, do të jetë pjesë e Grupit Parlamentar PDK, PD, LB, PSHDK, PKK.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

* * *

1. Miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisioneve parlamentare

Kryetari tha se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në mbledhjen e mbajtur më 17 dhjetor 2014, ka vendosur që në seancën e sotme plenare të procedohet me formimin e komisioneve parlamentare, në dy variante të mundshme:

1. Formimi i katërbëdhjetë (14) komisioneve parlamentare dhe

2. Formimi i trembëdhjetë (13) komisioneve parlamentare.

Kryetari tha se fillimisht do të procedojmë për variantin e parë - formimi i katërbëdhjetë (14) komisioneve parlamentare dhe e hapi debatin lidhur me këtë pikë.

Ndryshimet në propozimet e mëhershme në përbërjet e komisioneve parlamentare paraqitën Adem Grabovci nga GP-PDK, PD, LB, PSHDK, PKK, dhe Visar Ymeri nga GP VV, fjala e të cilëve është dhënë e plotë në transkript.

Në vazhdim, për fjalë u paraqitën deputetët: Ismet Beqiri, në emër të GP LDK; Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP AAK-së; Sasha Milosavljeviq, në emër të GP LS; Myfera Shinik, në emër të GP "6+", si dhe Alma Lama, Daut Haradinaj, Nuredin Ibishi, Sala Berisha-Shala dhe Shpejtim Bulliqi, fjala e të cilëve është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozim-vendimin për formimin, emërtimin, numrin dhe strukturën e katërbëdhjetë (14) komisioneve parlamentare.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 81,
Kundër ----- 28,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M
për formimin e 14 (katërmëdhjetë) komisioneve parlamentare
I.

Formohen 4 (katër) komisione të përhershme, sipas emërimit dhe përbërjes, si në vijim:

I. Komisioni për Buxhet dhe Financa, 11 anëtarë:

1. Naser Osmani, kryetar (GP LDK),
2. Safete Hadërgjonaj, zëvendëskryetare e parë, (GP PDK),
3. Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Latif Gashi, anëtar (GP PDK),
5. Labinota Demi-Murtezi, anëtare (GP PDK),
6. Besa Gaxherri, anëtare (GP LDK),
7. Bardhyl Metaj, anëtar (GP LDK),
8. Visar Ymeri, anëtar (GP VV),
9. Donika Kada-Bujupi, anëtare (GP AAK),
10. Jakup Krasniqi, anëtar (GP NISMA) dhe
11. Fikrim Damka, anëtar (GP “6+”).

II. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, 12 anëtarë:

1. Sasha Milosavljeviq, kryetar (nga komuniteti serb),
2. Agim Çeku, zëvendëskryetar i parë (nga komuniteti shumicë - PDK),
3. Myfera Shinik, zëvendëskryetare e dytë (nga komuniteti turk),
4. Agim Kikaj, anëtar (nga komuniteti shumicë - LDK),
5. Fisnik Ismaili, anëtar (nga komuniteti shumicë - VV),
6. Blerim Shala, anëtar (nga komuniteti shumicë - AAK),
7. Milka Vuletiq , anëtare (nga komuniteti serb),
8. Slavko Simiq, anëtar (nga komuniteti serb),
9. Jasmina Zhivkoviq, anëtare (nga komuniteti serb),
10. Qerim Bajrami, anëtar (nga komuniteti boshnjak),
11. Veton Berisha , anëtar (nga komuniteti egjiptian),
12. Danush Ademi, anëtar (nga komuniteti ashkali).

III. Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, 11 anëtarë:

1. Albulena Haxhiu, kryetare (GP VV),
2. Selvie Halimi, zëvendëskryetare e parë, (GP PDK),

3. Danush Ademi, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Agim Aliu, anëtar (GP PDK),
5. Nezir Çoçaj, anëtar (GP PDK),
6. Armend Zemaj, anëtar (GP LDK),
7. Agim Ademaj, anëtar (GP LDK),
8. Doruntina Maloku, anëtare (GP LDK),
9. Melihate Tërmkolli, anëtare (GP AAK),
10. Milena Miliçeviq, anëtare (GP LS) dhe
11. Jakup Krasniqi, anëtar (GP NISMA).

IV. Komisioni për Integritet Evropian, 11 anëtarë:

1. Teuta Sahatqija, kryetare (GP LDK),
2. Valdete Bajrami, zëvendëskryetare e parë, (GP NISMA),
3. Slobodan Petrović, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Xhavit Haliti, anëtar (GP PDK),
5. Rustem Mustafa, anëtar (GP PDK),
6. Luljeta Veselaj-Gutaj, anëtar (GP PDK),
7. Vjosa Osmani, anëtare (GP LDK),
8. Arben Gashi, anëtar (GP LDK),
9. Ilir Deda, anëtar (GP VV),
10. Blerim Shala, anëtar (GP AAK) dhe
11. Kujtim Paçaku, anëtar (GP “6+”).

II.

Formohen 10 (dhjetë) komisione funksionale, sipas emërimit dhe përbërjes, si në vijim:

I. Komisioni për Punë të Jashtme, 9 anëtarë:

1. Enver Hoxhaj, kryetar (GP PDK),
2. Teuta Rugova, zëvendëskryetare e parë, (GP LDK),
3. Qerim Bajrami, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Blerta Deliu-Kodra, anëtare (GP PDK),
5. Elmi Reçica, anëtar (GP PDK),
6. Ismet Beqiri, anëtar (GP LDK),
7. Puhie Demaku anëtare (GP VV),
8. Ramush Haradinaj, anëtar (GP AAK) dhe
9. Zafir Berisha, anëtar (GP NISMA).

II. Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, 9 anëtarë:

1. Nait Hasani, kryetar (GP PDK),
2. Sali Morina, zëvendëskryetar i parë, (GP LDK),
3. Jelena Bontiq, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Bekim Haxhiu, anëtar (GP PDK),
5. Shpejtim Bulliqi, anëtar (GP LDK),
6. Ismajl Kurteshi, anëtar (GP VV),
7. Teuta Haxhiu, anëtare (GP AAK),
8. Shukrije Bytyçi, anëtare (GP NISMA) dhe
9. Myfera Shinik, anëtare (GP “6+”).

III. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, 9 anëtarë:

1. Zenun Pajaziti, kryetar (GP PDK),
2. Sadri Ferati, zëvendëskryetar i parë, (GP LDK),
3. Kujtim Paçaku, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+2),
4. Xhevaire Izmaku, anëtare (GP PDK),
5. Alma Lama, anëtare (GP LDK),
6. Shqipe Pantina, anëtare (GP VV),
7. Pal Lekaj, anëtar (GP AAK),
8. Jelena Bontiq, anëtare (GP LS) dhe
9. Zafir Berisha, anëtar (GP NISMA).

IV. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, 11 anëtarë:

1. Muhamet Mustafa, kryetar (GP LDK),
2. Visar Ymeri, zëvendëskryetar i parë, (GP VV),
3. Sasha Milosavljeviq, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Besim Beqaj, anëtar (GP PDK),
5. Raif Qela, anëtar (GP PDK),
6. Sala Berisha-Shala, anëtare (GP PDK),
7. Fatmir Rexhepi, anëtar (GP LDK),
8. Blerim Grainca, anëtar (GP LDK),
9. Pal Lekaj, anëtar (GP AAK),
10. Fatmir Limaj, anëtar (GP NISMA) dhe
11. Duda Balje, anëtare (GP “6+”).

V. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 9 anëtarë:

1. Flora Brovina, kryetare (GP PDK),
2. Njomza Emini, zëvendëskryetare e parë, (GP LDK),
3. Fikrim Damka, zëvendëskryetar i dytë (GP “6+”),
4. Fadil Beka, anëtar (GP PDK),
5. Hatim Baxhaku, anëtar (GP LDK),
6. Besa Baftiu , anëtare (GP VV),
7. Time Kadriaj, anëtare (GP AAK),
8. Adem Hoxha, anëtar (GP LS) dhe
9. Shukrije Bytyçi, anëtare (GP NISMA).

VI. Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor, 9 anëtarë:

1. Fikrim Damka, kryetar (GP “6+”),
2. Salih Salihu, zëvendëskryetar i parë, (GP VV),
3. Velimir Rakiq, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Shaip Muja, anëtar (GP PDK),
5. Emilije Rexhepi, anëtare (GP PDK),
6. Murat Hoxha, anëtar (G/P - LDK),
7. Adem Salihaj, anëtar (GP LDK),
8. Lahi Ibrahimaj, anëtar (GP AAK) dhe
- 9 . Haxhi Shala, anëtar (GP NISMA).

VII. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 9 anëtarë:

1. Daut Haradinaj, kryetar (GP AAK),
2. Fadil Demaku, zëvendëskryetar i parë (G/P PDK),
3. Bojan Mitiq, zëvendëskryetar i dytë (GP LS),
4. Ganimete Musliu, anëtare (GP PDK),
5. Anton Quni, anëtar (GP LDK),
6. Nuredin Ibishi, anëtar (GP LDK),
7. _____, anëtar (GP VV),
- 8 . Zafir Berisha, anëtar (GP NISMA) dhe
9. Qerim Bajrami, anëtar (GP “6+”).

VIII. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë Kosovare për Inteligjencë, 9 anëtarë:

1. Haxhi Shala, kryetar (GP NISMA),
2. Rrustem Berisha, zëvendëskryetar i parë (GP AAK),
3. Duda Balje, zëvendëskryetare e dytë (GP “6+”),
4. Nuredin Lushtaku, anëtar (GP PDK),
5. Rafet Rama, anëtar (GP PDK),
6. Milazim Haliti, anëtar (GP LDK),
7. _____, anëtar (GP LDK),
8. Aida Dërguti, anëtare (GP VV) dhe
9. Slavko Simiq, anëtar, (GP LS).

IX. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, 9 anëtarë:

1. Besnik Bislimi, kryetar (GP VV),
2. Ali Sadriu, zëvendëskryetar i parë (GP LDK),
3. Duda Balje, zëvendëskryetare e dytë (GP “6+”),
4. Naim Fetahu, anëtar (GP PDK),
5. Adem Grabovci, anëtare (GP PDK),
6. Hajdar Beqa, anëtar (GP PDK),
7. Synavere Rysha, anëtare (GP LDK),
8. Bali Muharremaj, anëtar (GP AAK), dhe
9. Fatmir Limaj, anëtar (GP NISMA).

X. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, 9 anëtarë:

1. Lirie Kajtazi, kryetare (GP LDK),
2. Salihe Mustafa, zëvendëskryetare e parë (GP PDK),
3. Jasmina Zhivković, zëvendëskryetare e dytë (GP LS),
4. Mexhide Mjaku-Topalli, anëtare (GP PDK),
5. Etem Arifi, anëtar (GP LDK),
6. Mytaher Haskuka, anëtar (GP VV),
7. Teuta Haxhiu, anëtare (GP AAK),
8. Valdete Bajrami, anëtare (GP NISMA) dhe
9. Kujtim Paçaku, anëtar (GP “6+”).

III.

Fushëveprimi i komisioneve parlamentare sipas Shtojcës nr. 2 të Rregullores së Kuvendit duhet të harmonizohet në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Me qëllim të funksionalizimit dhe racionalizimit të punëve në komisione parlamentare është bërë përcaktimi i emërimit, numrit dhe strukturimi i tyre.

Numri i anëtarëve nëpër komisione parlamentare është përcaktuar në bazë të vëllimit të punëve dhe fushëveprimit të secilit komision.

* * *

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 13:50 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale